

Rezyme për temën e masterit

NDIKIMI SOCIAL I FILMAVE AKSION TEK FEMIJET: RASTI KOSOVA

Nga

Hana Bici

Mentori: Prof, Dr, Ibrahim Berisha

Me temën “Ndikimi social i filmave aksion tek fëmijët: Rasti Kosova,” jam munduar të shtjelloj ndikimet sociale, si ato negative por edhe pozitive të filmave aksion, mbi fëmijët (në rastin e Kosovës). Filmat e zgjedhur për analizë, janë 11 të zhanrit aksion, të kombinuar edhe me zhanre: superhero, fantazi, komedi, sc-fi, thriller, dramë, aventurë, krim, fantashkencë, dhe janë në gjuhën angleze.

Procedurat e realizimit të këtij punimi kanë qenë me anë të 4 metodave: Kuantitative, kualitative, metodës së vëzhgimit dhe analizës së përmbajtjes së 11 filmave aksion.

Metoda kuantitative përmbanë 120 anketa, të realizuara me respondentë të moshave 10-16 vjeç, kryesisht me 60 femra dhe 60 meshkuj. Vendet ku u realizuan ato jenë në komunat: Obiliq dhe Prishtinë. Metoda kualitative, përmbanë 7 intervista: me dy prindër, me dy mësime, me një sociologe, me një psikologe, dhe me një edukatore-psikologe. Gjithashtu në këtë temë janë të përfshira edhe disa “mendime” që kanë të bëjnë me çështjen e këtij hulumtimi, të huazuara nga librat, dhe disa nga interneti, dhe janë të cituara plotësisht.

Ndërkaq me anë të analizës së përmbajtjes së 11 filmave aksion, kam analizuar përmbajtjen e tyre si; stereotipet, seksizmin, dhunën, patriarkalizmin, fjalët eksplicite, skenat që shfaqin pije alkoolike, narkotikë, pastaj promovimin e armëve, shtresëzimin social që promovojnë përmbajtjen seksuale etj, pra duke tentuar të vë në pah ndikimet që tërë këto përmbajtje bëjnë tek të vegjëlit dhe mesazhin që përçojnë.

Në kuadër të këtij hulumtimi është e përfshirë edhe metoda vëzhguese, të cilën e realizova duke vëzhguar disa subjekte fëmijë të moshave 10-15 vjeç, në mënyrë që t'i shoh drejtpërdrejt

sjelljet e fëmijëve në fjalë, kur ata ishin të ekspozuar ndaj televizorit dhe personzheve-“heronjëve/heroinave” të filmave aksion, favorit të tyre.

Krejt ky hulumtim na dërgon në përfundim, se filmat aksion në shumicën e rasteve përçojnë inspirime dhe mesazhe jo të mira tek të vegjëlit, duke (keq) ndikuar në sjelljet sociale të tyre. Fëmijët zakonisht inspirohen dhe imitojnë personazhet kryesore të filmave, kjo dëshmohet nga metoda e vëzhgimit, nga rezultatet e anketave, dhe nga intervistat.

Kapitulli I i kësaj teme përmbanë: Një hyrje se çka është filmi aksion. Zhanri filmit aksion dhe Një historik i shkurtër i tij.

Kapitulli II përmbanë: Filmat aksion dhe ndikimi i tyre tek fëmijët, dhe Ndjekja e filmave aksion nga ana e fëmijëve.

Kapitulli III i kësaj teme përmbanë: Përshkrimin e 11 filmave aksion dhe Analiza sociologjike e përmbajtes së tyre mbi ndikimin social tek fëmijët. Ku janë të analizuara dhe të përshkruara ngjarjet e këtyre filmave: The Avengers, The Amazing SpiderMan, Wonder Woman, John Wick kapitulli 2, John Wick kapitulli 3, Rush Hour 2, Rambo, Last Blood 4, The Expendables, Undisputed III, Dead Pool 2, Suicide Squad.

Kapitulli IV përmbanë: Hulumtimin kualitativ- intervistat

Kapitulli V përmbanë: Hulumtimin kuantitativ, të paraqitur në formë të tabelave. Pytësori që është përdorur në hulumtimin kuantitativ. Përfundimin dhe Burimet/literatura.

Hipotezës së hulumtimit, se: Fëmijët mund të ndikohen në jetën sociale të tyre nga filmat aksion, i përgjigjen faktikisht të gjitha metodat hulumtuuese, por edhe mendimet e autorëve të ndryshëm të huazuara nga librat dhe linqet e internetit. Nëse ndalemi dhe i analizojmë metodën kuantitative dhe kualitative- intervistat, përgjigjet e tyre rezultojnë se: Filmat aksion ndikojnë në jetë sociale dhe psikologjike të fëmijëve. Kështuqë prindërit duhet të jenë më të kujdesshëm.

Me respekt,

Hana Bici.